



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË

Nr. 1564 Prot.

Datë 09 / 03 / 2020

VENDIM

Nr. 52, datë 09 / 03 / 2020

PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR (PDyV) PËR ZONËN E RE TË ZHVILLIMIT 1,
NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË KRUJË, BASHKIA KRUJË

Në vijim të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Krujë dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 29.01.2020 "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Fushë Krujë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese"; gjithashtu në mbështetje të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 "Për percaktimin e rregullave dhe te procedures se persheptuar per hartimin dhe miratimin e planit te detyruar vendor, si dhe procedures se miratimit te lejeve", kapitulli II, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 10.01.2020 "Për caktimin e Njësive Zbatuese për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore dhe financimin e tyre nga fondi për rindërtimin, miratuar në buxhetin e viti 2020",

VENDOSA:

1. Pranimin e kërkesës nr. 1588 datë 09.03.2020, nr. 427 date 09.03.2020 nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) për miratimin e Planit të Detyruar Vendor (PDyV) për zonën e re të zhvillimit 1, Njësia Administrative Fushë Krujë, Bashkia Krujë, e shoqëruar nga Raporti i Vlerësimit Teknik të PDyV-së dhe dokumentacionin e plotë të PDyV-së.
2. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor (PDyV-së) për Zonën e re të zhvillimit 1, Njësia Administrative Fushë Krujë, Bashkia Krujë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI BASHKISË

ARTUR BUSHI